



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 1048/5 Prot

Tiranë, më 08/10 /2013

REKOMANDIM

Nr. 33 datë 08/10 /2013

Mbështetur në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "*Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "*Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "**Bar Karamel Lounge**", Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 165 datë 04.09.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "**Bar Karamel Lounge**" me adresë, Rr. Dëshmorët e Kombit, Twin Towers, Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Plotësimi i formularit të njoftimit (neni 21).
- Ligjshmëria e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale, nëpërmjet përdorimit të sistemit të video survejimit (CCTV) sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" i ndryshuar, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Grupi i kontrollit administrativ:

- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësuesja e kontrolluesit.
- Inspektoi ambientet e punës të këtij kontrolluesi.

Kontrolluesi “Bar Karamel Lounge” kryen aktivitetin e tij në ofrimin e shërbimit ndaj klientit dhe gjatë këtij aktiviteti mbledh dhe përpunon të dhëna personale të ruajtura në sistemin e video survejimit (imazhe) për kategorinë klientë.

Për kategorinë “klientë” gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh dhe përpunon imazhe nëpërmjet përdorimit të sistemit të video-surveimit. Imazhet e lexohen si të dhëna personale pasi e bëjnë të identifikueshëm, drejtpërdrejt apo tërthorazi, një individ (parashikuar në pikën 2 të Udhëzimit nr. 3 datë 5..03.2010). Të dhënat personale (Imazhet) mblidhen nga sistemi i video-surveimit (gjithej 2 kamera) dhe administrohen në një kompjuter.

Të dhënat personale të klientëve, të siguruara nëpërmjet sistemit të video-surveimit, mblidhen më qëllim ruajtjen e qetësisë, sigurisë dhe mbarëvajtjes së punës. Të dhënat nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilat ato mblidhen dhe përpunohen.

Në kuadër të ligjshmërisë së mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale, nëpërmjet përdorimit të sistemit të video survejimit (CCTV), Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se:

- 1) Kontrolluesi duhet të vendosë një tabelë informuese për klientët lidhur me veprimin e sistemit të video-regjistrimit në ambientet e Barit (detyrim i parashikuar në shkronjën dh) të pikës 4 të Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar.
- 2) Afati i mbajtjes në sistem (kompjuter) i të dhënave personale të klientëve (Imazhet), është në përputhje me afatin ligjor të parashikuar në shkronjën c) të pikës 4 të Udhëzimit të cituar më sipër.
- 3) Kontrolluesi duhet të marrë masat e nevojshme për të kufizuar aksesin në kompjuter nëpërmjet vendosjes së emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit përkatës.
- 4) Në kuadër të mbrojtjes së sigurisë së të dhënave personale të klientëve (neni 27 i ligjit), kontrolluesi duhet të hartojë një rregullore të brendshme për sigurinë e të dhënave personale në të cilën të parashikohen masa konkrete për përpunimin, sigurinë, detyrimet e tij dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Bazuar në rregulloren të publikuar në faqen zyrtare [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al)). Ky detyrim parashikohet edhe në Udhëzimin nr. 22, datë 24.09.2012 për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë të të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël” dhe Udhëzimin nr. 3 të sipërcituar).

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

## REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, dhe shkronjës dh) të pikës 4 të Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, të vendoset një tabelë informuese lidhur me veprimin e sistemit të video-regjistrimit, në hyrje të Barit dhe brenda ambienteve të tij, bazuar në modelin e miratuar nga Komisioneri në Aneksin e Udhëzimit të cituar më sipër.



2. Përdoruesit e kompjuterit, në të cilin ruhen dhe përpunohen të dhënat personale të siguruara nga sistemi, të aksesojnë të dhënat në mënyrë të kufizuar vetëm nëpërmjet një emri/fjalëkalimi të vendosur në kompjuter.
3. Në zbatim të nenit 27, 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar, të hartohet një rregullore e brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të mbledhura nga sistemi i video survejimit, e cila të parashikojë masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit (Barit) dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave (klientëve). (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë).
4. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë rekomandim;
5. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
6. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

*Në mungesë dhe me porosi*

**KËSHILLTARI**

**BESHK PETRELA**

